

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJSHI TE KUFIZUAR.

"STERKAJ" sh.p.k.

Sot me dt. 1994, Lulesim Sterkaj, i biri i Markut
i d.tl. 1973, lindur ne Koplik e banues atje, ne cilesine e
Ortaku te Veten te shoqerise

V e n d o s i :

1. Krijimin e shoqerise "STERKAJ" sh.p.k., e cila ka objekt
te veprintarise se saj :

Prodhimin dhe tregetimin me shumice e pakice te lendet se
drurit per te gjitha destinacionet.

Tregetimin me shumice e pakice, import-ekspert te artikujve
te ndryshem industriale, fruta, duhan e cigare, karburante,
material ndertimi etj.

Ndertimin e objekteve te ndryshme te banimit, kulturore e
sportive, industriale, rrugore, veprave te artit etj.

2. Shoqeria ka qender ne Dedaj- Koplik.

3. Jetegjatesia e shoqerise eshte 30 vjet.

4. Administrator i Veten i Shoqerise eshte Ortaku i Veten i
saj LULEZIM STERKAJ, i biri i Markut, i d.tl. 1973, lindur e
banues ne Dedaj- Koplik.

5. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke.

ORTAKU I VETEN I SHOQERISE

/ Lulesim Sterkaj /

S T A T U T



I SHOQERISE "STERKAJ" sh.p.k.

Kapitali themeltar : 100.000 leke.

Administrator i Vetem : LULEZIM STERKAJ.

K r e u I.

EMERTIMI, OBJETI I VEPRIMTARISE, QENDRA, JETEGJATESIA.

Nani I. Ne baze te Ligjes Nr. 7512 dt. 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit" dhe Ligjes Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", Lulezim Sterkaj, ne cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise krijon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "STERKAJ sh.p.k.

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar. Ajo eshte personi juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjispcionin shqiptar dhe aktet e saj themeluese.



Ajo perggjigjet perpara te treteve vetem me kapitalin e saj themeltar dhe vetem per detyrimet e pranuara proj saj dhe jo te ortakut apo te artakeve.

Noni A. Objekti i veprixtarise se shoqerise eshte :

- Prodhimi dhe tregetimi me shumive e pakice i lenden se drurit per te gjitha destinacionet;
- Tregetim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem ushqimore e industriale, fruta, duhan e cigare, karburante, material ndertimi import-eksport.
- Ndertim te objekteve te ndryshme te banimit, kulturore e sportive, industriale, rrugore, veprave te artit etj.

Noni B. Shoqeria ka qender ne fshatin Dedaj-Koplik.

Me vendim te saj ajo mund te krijoje qendra dytesore te saj si perfaesi, agjensi apo filiale.

Noni C. Jetegjatesia e shoqerise eshte 30 vjet.

Me vendim te saj apo kur verifikohen rrethana te tilli, qe urdherojne shprehimisht ate, shoqeria mund te shperndahet perpara ketij afati. Me kete rast shoqeria vijet ne likuidim, sipas rregullave qe parashikohen ne kreun e fundit te ketij statuti.

K r e u II.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE DHE KUOTAT.

Neni 5. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Ai i perket teresisht Ortakut te Vetem, eshte nensh-kruar e shlyer teresisht prej tij ne Banken Tregetare Ag-rare, Dega Koçlik ne Nr. Llogarise 504/116.

Ky kapital mund te ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem, vendim i cili regjistrohet ne Librin e Shoqerise.

Eshte e ndaluar qe kontributet ne kapitalin themel-tar te shoqerise te perfaqeshen ne letra me vlera te tre-getueshme apo sherbime.

Neni 6. Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne kupta, vlera e te cilave eshte jo me e vogel se 1.000 le-ke.

Autoriteti i vetem qe mund te disponojm per trans-ferimin e kuotave eshte Ortaku i Vetemi i Shoqerise.

Neni 7. Shoqeria mund te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar! Ne rast shitjeje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit themeltar te sho-querise, me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i ribleje keto pjesa e te deklaroje zvogelimin eventual te kapitalit te saj themeltar.



K R E U III.

ORGANET E SHOQERISE, ADMINISTRIMI.

Noni 8. Ortaku i Vetem eshte organi me i larte i shoqerise. Atij i takojne te gjitha kompetencat qe ne Ligjen "Per Shoqerite Tregetare" i jene dhene Asamblese se Ortakeve.

Vendimet e Ortaikut te Vetem regjistrohen ne Librin e Shoqerise.

Noni 9. Qdo i interesuar mund te kerkoste ne Gjykaten e Re-thit Tirane snullimin e vendimeve te Ortaikut te Vetem te marr ne kundershtim me dispozitat ligjore e normat e ketij statuti.

Noni 10. Shoqeria administrohet nga nje administrator i Vetem, i cili aktualisht eshte edhe Ortaku i Vetem i Shoqerise.

Noni 11. Mandati i administratorit eshte i pakufizuar ne kohë.

Noni 12. Administratori ka te drejto te kryeje edo veprim administrimi ne interes te shoqerise, brenda objektit te veprintarise se saj.

Noni 13. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur kete nuk perfshihen ne objektin e veprintarise se saj, ne perjashtim te rasteve kur ajo preven se te tretet e dinin se akti i administratorit tejkalente objektin e veprintarise se shoqerise, ose ne rrethana te aktuara nuk mund ta injeronin kete fakt.

Neni 14. Administratorit i takon firma e shoqerise dhe perfaqesimi i saj ndaj te treteve.



K r e u IV.

BILANCI DHE FITIMET.

Neni 15. Viti finanziar i shoqerise mbyllt me 31.12. te çdo viti. Me kete rast administratori ben inventarin dhe llogerite vjetore sipas dispozitave per kontabilitetin.

Bilancit i bashkohen :

- Nje situacion per garancite e dhena nga shoqeria.
- Nje situacion per sigurimet e bera nga shoqeria.

Neni 16. Perderisa "rezerva e domosdoshme" te arrije 1/10 e kapitalit themeltar shoqeria eshte e detyruar te depozitoje ne fund te çdo viti 1/20 e fitimit te realizuar.

Neni 17. Fitimet, pasi te jene depozituar shumat e urdheruara per rezerven etj. i takojne teresisht Ortakut te Vetem.

Neni 18. Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda dates 31.3. te vitit pasardhes.

Neni 19. Ne rast se shoqeria vihet ne likuidim, likuidatori merre te gjitha atributet e Administratorit te Shoqerise.

./..

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Xhevdet Krasniqi", is positioned at the bottom right of the document.